

Ndryshimi i fundit: 04/09/2009 - 09:04

Kerko:

Kerko!

FILLIMI

Kategorite

- ▶ Politike
- ▶ Ekonomi
- ▶ Aktualitet
- ▶ Speciale
- ▶ Rrethe
- ▶ Opinion
- ▶ Shëndetsi
- ▶ Sport
- ▶ Kulture
- ▶ Bota & Rajon
- ▶ Sociale
- ▶ Panorama Supplement

Panorama Newsletter

E-mail Address

- Regjistrohu
- C'regjistrohu

Dergo!

Sherbime

- ▶ Hosroskopi
- ▶ Letra ne Redaksi

Te tjera

- ▶ Spektakel
- ▶ Televizion
- ▶ Auto & Moto
- ▶ Libra

Lojra

- ▶ Smashing
- ▶ Tetris
- ▶ Packman
- ▶ Snake
- ▶ Shah

Moti

- Tirane
- Durres
- Vlore
- Shkoder
- Korce

Chat

- ▶ Albasoul
- ▶ Fajtori
- ▶ Albnetwork

Nis heqja e pesticideve nga stacioni i Bajzës, pastrohet për 30 muaj

» Vendosur: 07/02/2008 - 06:46

• SHKODER - Pas plot 17 vitesh do të zgjidhet përfundimisht problemi i pesticideve që ndodhen në stacionin hekurudhor të Bajzës në Malësinë e Madhe.

Rehabilitimi i zonës së ndotur dhe që ishte kthyer në një makth jo vetëm për banorët e zonës, por edhe për drejtuesit lokalë do të bëhet i mundur në sajë të një fondi të dhënë në formë granti nga qeveria holandeze. Koordinatori i këtij projekti, Lirim Sejdia, thotë se "projekti për largimin dhe asgjësimin e sasisë së pesticideve që ndodhen prej shumë vitesh në një magazinë të stacionit hekurudhor do të zgjasë për rreth 30 muaj". Ndërkohë, Sejdia sqaron se pas largimit të pesticideve do të bëhet studimi i shkallës së ndotjes së gjithë zonës dhe marrja e masave për rehabilitimin e saj. Bëhet fjalë për një sasi prej 200 tonësh të ardhur nga Gjermania dhe fabrikat kimike të Shqipërisë, të cilat janë të vendosura në një nga magazinat e këtij stacioni hekurudhor që në vitin 1991. Ato janë të vendosura në një prej magazinave të stacionit, të cilat janë drejt degradimit dhe të hapura në disa anë. Era e rëndë është shoqëruese sapo i afroresh vendit ku ndodhen lëndët e rrezikshme, ndërsa përreth janë së paku 1000 banorë që i kanë shtëpitë fare pranë magazinës ku ndodhen të depozituara këto pesticide. Mes tyre ka mbetje të ngurta, mbeturina lëkurësh të këpucëve, mbi të cilat janë derdhur lëndët helmuese në gjendje të lëngët. Nga qëndrimi shumë i gjatë në ambientet e këtij stacioni, një pjesë e ambalazhimit të pesticideve janë dëmtuar duke zhdukur të dhënat respektive. Prania e sasisë së pesticideve ka pasuar me ndotjen e zonës si dhe me mjaft probleme shëndetësore të banorët. Këta të fundit janë ankuar se nga ndotja e zonës, kanë pasur probleme dhe me produktet bujqësore. Ekspertët pohojë se mbetja toksike është natro-ferro-silicium me formulë Na₂S₂F₆, e klasifikuar si mjaft e rrezikshme, pasi në momentet kur fryn erë rrezatimi radiologjik kancerogjen i sasisë prej 200 tonësh mund të japë efekte në një rreze deri në 50 km. Në stacionin hekurudhor ndërkombëtar të Bajzës kryhet mbi 60% të planit të të gjithë hekurudhës shqiptare, pasi transporti i mallrave është 50% më i lirë. Në këto kushte pjesa më e madhe e ushqimeve që vijnë nga jashtë Shqipërisë, si gruri, mielli, sheqeri, orizi, vaji, kripa futen nga stacioni hekurudhor ndërkombëtar i Bajzës, ku dhe rreziku i marrjes së rrezatimit toksik është tepër i frikshëm. r.d

200 TONE

helme, që përbëjnë rrezik të madh për banorët e zonës së Malësisë së Madhe, pritet të largohen së shpejti nga stacioni ndërkombëtar i Bajzës, ku kanë qëndruar për 17 vjet me radhë



Horoskopi 2009

Suplementi STUDENTI

STUDENTI
supplementi

MATURA SHTETËRORE
Letërsia, përgjigjet
zyrtare për të gjitha
profilat e shkollave

Arkiva e lajmeve

Shtator	2009	>
1	2	3
4	5	6
7	8	9
10	11	12
13	14	15
16	17	18
19	20	21
22	23	24
25	26	27
28	29	30

Lajme të ndryshme

Skadon afati 30 ditor, pesë partitë s'kthejnë lekët në KQZ

Rehn: Zgjedhjet, më të mira se në '05

Burgu, asnjë leje pas 20 qershorit

Maqo Lakrori: Unë do ta fitoj këtë garë

Rama: Pse bojkotojmë Kuvendin

Sondazhe

A mund të konceptohet një grua shperfillëse ndaj look-ut ?

- Po
- Jo

Voto

Rezultatet



PANORAMA & PANORAMA SPORT



PANORAMA PLUS & UNE GRUAJA



Reklama



UNIVERSITETI EUROPIAN
I TIRANES
UET GUIDE 2009 - 2010
(Shkarkoje ketu ne PDF)

